



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	14. 01 2021	1	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtori J Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPIMSHUK	137/2021		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 361/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësi, ka shqyrtuar ankesën A.nr.361/2020 të datës 17.11.2020, të parashtruar nga me adresë banimi Rr."12 Qershori 1999", nr. 8, Pejë, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.01.2021, në mënyrë unanime mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.361/2020 e datës 17.11.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative për Përkrahje", në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e protokolluar me datë 17.11.2020, me numër 2616/2020, duke kërkuar që ti njihet e drejta për kompensim shtesë në pagë prej 200 Euro për fushën e Teknologjisë Informative, për të ardhmen si dhe kompensimin retroaktiv nga data e pranimit në këtë pozitë respektivisht nga data 04.05.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 27.11.2020, ka proceduar tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën 09.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat lëndës.

Bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kryetari i Këshillit, me kërkesë të Kryetarit të Kolegjit, më datë 28.12.2020, ka nxjerr Vendimin VK.nr.25/2020 përmes të cilit ka vazhduar afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën Nr.361/2020.



Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore, Kolegji ka administruar këto prova: Ankesën A. nr.361/2020 e parashtruar më datë 17.11.2020, me numër protokollit 2616/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 27.11.2020; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 16.10.2020; Akt Emërim i datës 29.04.2020; Rekomandim i datës 30.06.2011; Certifikatë e datës 23.07.2019; Diplomë me nr.625/20 e datës 11.07.2020; Vendim me nr. 02/39 i datës 08.10.2008; Lista dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Pliko e datës 13.11.2020; Përgjigje në ankesë e datës 09.12.2020; e-mail nga _____ për _____ i datës 18.11.2020; e-mail nga _____ për _____ i datës 17.11.2020; Ankesë Komisionit për Shqyrtim të Ankesave i datës 23.09.2020; provat shtese nga MPB -vendimi Nr. 34/2016 i datës 15.09.2016 dhe vendimi nr. 10/2018 i datës 26.02.2018; Vendim i datës 28.12.2020; Kërkesë për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës i datës 28.12.2020; e-mail nga _____ për _____ i datës 12.01.2021; Vendim i datës 09.09.2015; Vendim i datës 30.10.2020; Vendim i datës 31.07.2008; Vendim i datës 08.10.2008.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, _____ është e pa bazuar sepse:

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon që Këshilli duhet ta obligoj Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme SKGJK) që t'i njihet e drejta për kompensim shtesë në pagë prej 200 Euro për fushën e Teknologjisë Informativë, për të ardhmen si dhe kompensimin retroaktiv nga data 04.05.2020, duke ju referuar vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 07/29 të datës 31.07.2008 dhe Nr.02/39 të datës 08.10.2008.

Bazuar në provat e lëndës përkatësisht Akt Emërimin e datës 29.04.2020, Kolegji ka konstatuar se ankuesi ne mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, është emëruar në pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informativë për Përkrahje", në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përkatësisht në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan. Ankuesi është në periudhë provuese nga data 04.05.2020 deri 03.05.2021.

Me datë 23.09.2020, ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më kërkesë që t'i njihet e drejta e kompensimit shtesë për Teknologjinë Informativë, ndërsa me datë 16.10.2020 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me vendimin KA nr. 29/2020, është shpallur jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, e të cilin vendimi ankuesi nuk e ka atakuar me ankesë të parashtruar në Këshill.

Nga e-maili i datës 17.11.2020 i Drejtorit të Administratës së Përgjithshme të SKGJK drejtuar ish anëtarëve të Komisioni për shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës për nëpunësit civil, konstatohet se SKGJK- ja disa herë i është drejtuar me kërkesë Ministrisë së Administratës Publike për kompensim të shtesave për zyrtaret e IT-së, të cilët janë pranuar gjatë vitit 2019 e tutje, por që asnjëherë nuk ka marrë një përgjigje nga kjo ministri lidhur me këtë çështje.


Ndërsa në përgjigje të e-mailit të datës 17.11.2020, njëri nga ish anëtarët e Komisioni për Shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës, ka njoftuar Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor se *"komisioni për të cilin ju aludoni nuk është funksional, për këtë arsye ju kam njoftuar se duhet të nxjerr Vendim Qeveria për lejimin e shtesave që keni kërkuar"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar vendimet e Qeverisë së Kosovës Nr. 07/29 të datës 31.07.2008 dhe Nr.02/39 të datës 08.10.2008, nga dhe ka vlerësuar se Qeveria ka miratuar pagesën shtesë në paga për kategori të veçanta të profesioneve deficitare respektivisht listën e pozitave dhe shtesave në paga për Teknologji Informative dhe Inxhiniering, duke autorizuar Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave si institucione përgjegjëse për zbatim të këtyre vendimeve.

Bazuar në provat shtesë të dërguara nga Ministria e Punëve të Brendshme, Kolegji ka konstatuar se Ministri i Administratës Publike bazuar në Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ka themeluar Komisioni për shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës për nëpunësit civil, i cili Komision ka qenë funksional deri me datë 26.02.2018, përkatësisht deri me nxjerrjen e Vendimit Nr. 10/2018 të Ministrisë së Administratës Publike, me të cilin është anuluar vendimin Nr.34/2016 i datës 15.09.2016 mbi themelimin e këtij Komisioni.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimor të ankuesit, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 14 ku përcaktohet se *"Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"*, dhe nenin 17 ku parashihet se *1. Për pozitave ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është shumë më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit për ato pozita ose lloje të pozitave nga administrata publike, ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut, e cila mund të paguhet për këto pozita ose lloje të pozitave. 2. Kërkesa për miratimin e kësaj shtese nga Qeveria duhet të bazohet në një analizë, e cila tregon se për këto pozita ose lloje të pozitave: 2.1. çmimi i tregut për aftësitë në fjalë është shumë më i lartë se paga që ofrohet nga Shërbimi Civil; 2.2. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve është e papranueshme; 2.3. pritet se shtesa do të ndikojë në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit. 3. Kushtet dhe metoda për llogaritjen e shumës së shtesave mbi pagën bazë për kushtet e tregut përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa"*

Po ashtu Rregullorja Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 përcakton se: *"Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut, institucioni duhet t'i ofrojë ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën që përmban: 2.1 Arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut për pozitën përkatëse, së bashku me një analizë, e cila dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, duke përfshirë informata mbi nivelin e pagës që paguhet nga organizatat e tjera në tregun e Kosovës për pozita të ngjashme. 2.2 Listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civil për çdo pozitë dhe 2.3 Koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushtet e tregut të punës"*.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me faktin e adresimit të kërkesës në Ministrinë përgjegjëse për aprovim të shtesave për zyrtarët e IT-se, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të përcaktuara me Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ndërsa është kompetencë e Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike që në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Financa, të kërkojnë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozita të caktuar ashtu siç është definuar me nenin 8 të kësaj Rregullore.

Meqenëse, Qeveria ende nuk ka një vendim lidhur me kompensimin e pagës shtesë për fushën e IT dhe se Komisioni për shqyrtimin e shtesave mbi pagën bazë për kushte të tregut të punës, nuk është funksional, kërkesa e ankuesit e parashtruar në ankesë pranë KPMSHCK-se, konsiderohet kërkesë në pritje për realizim deri në një Vendim të Qeverisë lidhur me këtë çështje, Andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.361/2020

Çlirim Zeka



Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

